

Nga SHP Dibër dhe Qendra Zhupë, për herë të parë është zgjedhur si anëtar i Kuvendit të LSHPM dhe si anëtar i Këshillit Ekzekutiv të LSHPM prej vitit 1998 deri në vitin 2011, ndërsa prej vitit 2011 është zgjedhur nënkryetar i Kuvendit të LSHPM, derisa nga viti 2015 është kryetar i Kuvendit të LSHPM me mandat prej katër viteve, gjegjësisht deri në vitin 2019

**Shumë vite ju jeni aktiv në jetën pensioniste në SHP Dibër dhe Qendra Zhupë, por edhe në Lidhjen e shoqatave të pensionistëve të Maqedonisë. Na tregoni diçka për atë.**

**POCESTA:** Është e vërtetë se shumë vite jam aktiv në jetën pensioniste fillimisht në SHP Dibër dhe Qendra Zhupë, ndërsa pastaj edhe në organet dhe trupat e LSHPM. Më saktësisht, prej vitit 1995 deri në vitin 2015 kam kryer funksionin e kryetarit të Kuvendit edhe të SHP Dibër dhe Qendra Zhupë, ku si bashku me anëtarin kemi arritur rezultate mahnitëse, në pajtim me aktivitetet dhe synimet e parapara programore, çdoherë të koordinuara dhe të harmonizuara me planet dhe programet e LSHPM, në kuadër të dispozitave statutare, me qëllim të realizimit dhe mbrojtjes së interesave të anëtarëve të tyre, si dhe për përfaqësim të vetëm dhe reprezentativ të interesave tona pensioniste dhe obligimeve para zyrtarëve dhe institucioneve shtetërore. E gjithë puna jonë, të gjitha aktivitetet, angazhimet, përpjekjet tona dhe rezultatet tona të arritura anëtarëve ka ditur t'i vlerësojë dhe lehtë dhe me modesti mund të them se kjo Shoqatë është numëruar në mesin e më të suksesshmeve në LSHPM. Nga SHP Dibër dhe Qendra Zhupë, për herë të parë jam zgjedhur si anëtar i Kuvendit të LSHPM dhe si anëtar i Këshillit Ekzekutiv të LSHPM prej vitit 1998 deri në vitin 2011, ndërsa prej vitit 2011 jam zgjedhur nënkryetar i Kuvendit të LSHPM, ndërsa prej vitit 2015 jam kryetar i Kuvendit të LSHPM me mandat prej katër viteve, gjegjësisht deri në vitin 2019. Të rezimoj, në pajtim me atë të thënë më herët, jam aktiv në jetën pensioniste në SHP Dibër dhe Qendra Zhupë si dhe në LSHPM prej vitit 1995 deri më tani, gjegjësisht tash më 22 vjet, ndërsa ajo më besoni, arrihet vetëm me punë të ndershme dhe të vazhdueshme, sepse përceptimi i synimit tim jetësor është arritja e jetës së mirë për pensionistët tanë dhe jam krenar dhe i lumtur kur gjendem në mesin e kolegëve të mi pensionistë.

**Si rezultat i angazhimit tuaj për realizimin e të drejtave të të gjithë pensionistëve pavarësisht përkatësisë së tyre etnike dhe fetare, ju jeni kryetari i parë shqiptar në Kuvendin e LSHPM, asociacion multietnik në të cilin anëtarsohen 250 000 pensionistë. Si menaxhoni me këtë funksion?**

**POCESTA:** Me këtë rast kam nderin dhe kënaqësinë t'u falemnderohem të gjithë kolegëve të mi pensionistë, organeve të shoqatave, anëtarëve të LSHPM, posaçërisht kolegëve – anëtarë të Kuvendit dhe kryetarit të LSHPM, të cilët më kanë mundësuar 22 vjet, pandërprerë të jem aktiv mes pensionistëve të RM dhe të zgjidhem si kryetar i parë shqiptar i Kuvendit të LSHPM. Në LSHPM kemi rezul-

Bisedë me Besnik Pocesta, kryetar i Kuvendit të LSHPM

## Energjinë e harxhoj në punë dhe familje



tate të mahnitshme në realizimin e të drejtave të të gjithë pensionistëve, pavarësisht përkatësisë së tyre etnike dhe fetare, si rezultat i punës dhe angazhimit të LSHPM, në krye me kryetarin Dragi Argirovski. Por në të gjithë atë gjendet edhe kontributi im personal, falë përvojës dhe punës sime personale, normalisht në pajtim me Statutin e LSHPM, organizatë e cila definohet si asociacion joqeveritar, jopartiak dhe multietnik i pensionistëve në R. Maqedonisë.

Në këtë funksion me përgjegjësi, kryetar i Kuvendit të LSHPM, gjegjësisht i pari mes anëtarëve të barabartë në Kuvend, jam pranuar mirë dhe me duhet të theksoj mbështetjen e madhe nga të gjithë kolegët e mi pensionistë, anëtarë të organeve dhe trupave të LSHPM si dhe nga e udhëheqësisë së ngushtë të asociacionit tonë, sepse unë si shqiptar mundohem të jem kryetar i Kuvendit të të gjithë 250000 pensionistëve. Me përkushtimin tim dhe përkushtimin e anëtarëve të tjerë të udhëheqësisë së Lidhjes, me të gjithë së bashku mundohem të ndihet jetesa multietnike e pensionistëve në RM.

**Gjatë kohës së pjesëmarrjes suaj në organet dhe trupat e LSHPM në masë të madhe është përmirësuar informimi i pensionistëve shqiptarë. Na tregoni diçka në lidhje me këtë.**

**POCESTA:** Në LSHPM i është kushtuar rëndësi e madhe informimit të pensionistëve për të gjitha aktivitetet e realizuara në LSHPM dhe në të gjitha SHP, anëtarë të Lidhjes. Publikimi i informacioneve për punën është transparente dhe reale, posaçërisht me ardhjen e kryetarit Dragi Argirovski në krye të asociacionit tonë. Informimi u përmirësua dhe u zgjerua, pasi gjatë pjesëmarrjes sime në trupat dhe organet e LSHPM në masë të madhe u përmirësua informimi i pensionistëve – shqiptarë. Në lidhje me këtë do të theksoj se gazeta mujore informative e LSHPM "Penzioner Plus" ka një faqe të tërë në gjuhën shqipe. Gjithashtu, një herë në muaj në gazetën ditore në gjuhën shqipe "Koha" ka një faqe të posaçme për pensionistët me përzgjedhje të një pjese të aktiviteteve. Në lidhje me atë të thënë më lartë, është e rendit të theksoj se në SHP Tetovë,

SHP Gostivar, SHP Strugë, SHP Çair, SHP Saraj, SHP Dibër dhe Qendra Zhupë dhe SHP Kërçovë, materialet e organeve dhe trupave të tyre përgatiten dhe shkruhen në gjuhën maqedonase dhe gjuhën shqipe, ndërsa në shoqata përdoret dhe flitet edhe gjuha maqedonase edhe gjuha shqipe. Është për t'u shënuar se në SHP Kumanovë publikohet informator në gjuhën maqedonase dhe gjuhën shqipe.

LSHPM ka përgatitur Monografi "Aktivitetet pensioniste për respekt" me rastin e 70 vjetorit e organizimit të pensionistëve në Maqedoni (1946-2016). Në seancën ku u vendos që monografia të botohet edhe në gjuhën shqipe, është propozuar që e njëjta të botohet edhe në gjuhët tjera, nëse sigurohen mjetet, gjë që u miratua njëzëri.

**I nderuar kryetar Pocesta. Ju keni ndikim të madh edhe në bashkëpunimin ndërkombëtar të LSHPM, posaçërisht me pensionistët nga Shqipëria. Si erdhi deri tek një bashkëpunim i këtillë?**

**POCESTA:** Për bashkëpunimin ndërkombëtar të LSHPM, gjerësisht është folur në monografinë e LSHPM me rastin e jubileit të madh. Mua më mbetet shkurtimisht të përsëris, gjegjësisht të shtoj se ka edhe një ndikim timin modest në zhvillimin e bashkëpunimit ndërkombëtar. Në fillim, spontanisht, si kryetari i SHP Dibër dhe Qendra Zhupë, vendosa kontaktet fillestare dhe bashkëpunim, me qëllim të këmbimit të përvojave me Konfederatën e sindikatave dhe pensionistët nga Pogradeci – Republika e Shqipërisë ku pastaj u bashkangjit edhe SHP Ohër dhe Debërcë. Ai bashkëpunim zgjatë edhe sot e kësaj dite, me kënaqësi të të dyja palëve. Të theksoj se jam shpallur si anëtar nderi i asaj Konfederate, ndërsa një nderë të tillë ka edhe kryetari i SHP Ohër dhe Debërc, Gjorgji Tërçeski. Pastaj ky bashkëpunim u zgjerua edhe në nivel të LSHPM, me këmbim të vizitave dhe takimeve të delegacioneve nga të dyja asociacionet, në të cilat çdoherë personalisht kam marrë pjesë, fillimisht si kryetar i SHP Dibër dhe Qendra Zhupë, ndërsa pastaj si anëtar i Këshillit ekzekutiv dhe nënkryetar i Kuvendit të LSHPM.

Në shtator të vitit 2013, në

Lubjanë ka marrë pjesë delegacioni i LSHPM dhe pensionistët e SHP Tetovë, me dy ansamble me këngë dhe tradita maqedonase dhe shqipe, ndërsa krahas meje, si shëf i delegacionit, kanë marrë pjesë edhe përfaqësuesit e SHP Tetovë, Shaban Azizi dhe Gjoko Eftovski. Në vizitën kthyesë në LSHPM të delegacionit të Lubjanës, R. Sllovenisë në vitin 2015, morra pjesë personalisht në pritjen dhe qëndrimin e tyre në Shkup. Dhe në fund, në bazë të vendimit të KE të LSHPM, prej më 15.08.2017 jam angazhuar dhe e kam për detyrë të vendosë bashkëpunim mes LSHPM me Lidhjen e pensionistëve të R. së Kosovës, i cili aktivitet është në vijim dhe presim dhe shpresojmë se i njëjti do të realizohet. Do të thotë se kam ndikim personal në vendosjen e bashkëpunimit të ndërsjellë me pensionistët nga R. e Shqipërisë, por më duhet të theksoj se e njëjta është arritur në pajtim me besimin që më është dhënë nga ana e LSHPM.

**Ju jeni anëtar i Këshillit për siguri nacionale në Ministrinë e punës dhe politikës sociale të RM. Na tregoni për veprimet e juaja në atë aspekt.**

**POCESTA:** Me propozim të LSHPM unë jam anëtar i Këshillit për siguri sociale në kuadër të Ministrisë së punës dhe politikës sociale të R. Maqedonisë së bashku me Stanka Trajkova, sekretare e KE të LSHPM. Më 15 qershor të vitit 2017, në mbledhjen e mbajtur, në të cilën mori pjesë edhe ministrja Milla Carovska, janë shqyrtuar dhe miratuar shumë projekte si detyra programore për vitin 2018, që do të kenë kuptimin e avancimit të pozitës sociale, integritimit dhe përmirësimit të standardit jetësor të shfrytëzuesve të pensioneve. Për kënaqësinë tonë Projektet të cilat kanë qenë të propozuara nga ana e LSHPM janë miratuar thuajse të gjitha.

**Aktivitet e juaja janë të shumta, ndërsa ju jeni në gjenar të tretë të jetës. Si e arrini gjithë këtë? Prej nga merrni atë energji?**

**POCESTA:** Është e vërtetë që jam në pjesën e tretë jetësore dhe aktivitetet janë të shumta. Mendoj dhe besoj se të njëjtën e arrijë vetëm dhe kryesisht me punë dhe dashuri ndaj mjedisit që më rrethon, ku çdoherë ndihem i lumtur dhe i mbushur dhe e gjithë kjo më jep energji të vazhdoj me realizimin e obligimeve dhe aktiviteteve që i kemi realizuar për të mirën e pensionistëve dhe për jetën e lumtur të kolegëve të mij pensionistë, tek të cilët çdoherë kam gjetur mirëkuptim dhe nga të cilët kam fituar respekt të madh. Për të arriturat në këto 62 viteve aktive punë prej të cilave 22 vite janë të mbushura me aktivitet në LSHPM përjetësisht i jam falënderues bashkëshortes sime tani të ndjerë dhe familjes, ndërsa për shëndetin dhe jetën deri në stinën e tretë, falë Zotit.

### Garat sportive republikane të pensionistëve



### Fitues ishin të gjithë

Më 2 shtator të vitit 2017 në Koçan u mbajt olimpiada republikane e pensionistëve për herën e 22 për nder të pavarësisë së Republikës së Maqedonisë dhe 20 shtatorit, Ditës së pensionistëve të vendit tonë. Të dyja festat pensionistëve ua uroi ministrja e punës dhe politikës sociale Milla Carovska, e cila në fjalimin e saj para fillimit të garave në stadiumin e Koçanit mes tjerash tha:

–Me të vërtetë kam nderin që kam mundësinë tu drejtohem në një manifestim të këtillë solemn të Lidhjes së shoqatave të pensionistëve të Maqedonisë. Personat e moshuar dhe pensionistët në Maqedoni posedojnë mençurinë, të cilën ne të rinjtë duhet ta shfrytëzojmë. Së bashku me ju do të vazhdojmë të punojmë dhe të përcaktojmë nevojat e pensionistëve dhe personave të moshuar dhe ti implementojmë me dinamikë të caktuar. Projektet e filluara do të vazhdojnë edhe në vitin 2018 sepse për ato janë siguruar mjete nga buxheti. Si patronazh i këtij manifestimi, ju uroj fillimin e garave dhe ju dëshiroj lojëra të suksesshme, suksese më të mira dhe të shkëlqyeshme e vitin e kaluar". Fjalimi i ministres është përcjellë me duartrokitje nga të pranishmit që ishin të nderuar nga prezenca e saj dhe fjalët e bukura. Pastaj të pranishmit i përshëndeti Gjorgji Serafimov, kryetari i SHP Koçan, nikoqir dhe bashkorganizator i këtij manifestimi që të gjithë të pranishmëve u dëshiroi mirëseardhje ndërsa sportistëve rezultate të mira. Mysafirëve dhe garuesve ju drejtua edhe kryetari i Komunës së Koçanit, Ratko Dimitrovski, i cili është shembull në bashkëpunimin me pensionistët. Në emër të LSHPM rreth 1300 pensionistëve prej 40 shoqatave anëtare të LSHPM që kanë marrë të drejtën për pjesëmarrje në këto gara sportive republikane të pensionistëve, ju drejtua Saltir Karovski, nënkryetari i KE të LSHPM. Ai fillimisht i përshëndeti të pranishmit, ndërsa pastaj i shpalli garat si të hapura. Në këto gara të 22-ta republikane sportive të pensionistëve në përgjithësi më të mirë ishin garuesit nga SHP Prilep dhe morën kupën fituese. Kupën SHP Prilep ua dorëzoi kryetari i LSHPM Dragi Argirovski i cili fillimisht pensionistëve të konfesionit islam u uroi festën e Kurban Bajramit dhe pastaj mes tjerash theksoi: "Mbaroi Olimpiada e 22-të 2017, e cila ishte olimpiadë e sportit, shoqërimet dhe bashkëjetesës. Kështu të bashkuar dhe të shoqëruar të vazhdojmë edhe në të ardhmen në Olimpiadat në vijim për të cilat shpresoj se do të bëhen ballkanike dhe ndërkombëtare. Pensionistëve të Prilepit u uroi për suksesin dhe u dëshiroi që të fitojnë edhe më shumë kupa."

(Kalina S. Andonova)